

5-8 tetor 2011

Autoriteti portual në panairin ndërkombëtar “Transport logjistik 2011” të Shkupit

-APD, pjesmarrëse në shtatë Panairë gjatë këtij viti-

Autoriteti portual i Durrësit ka marrë pjesë këto ditë në Panairin ndërkombëtar “Transport logjistik 2011” që është organizuar në Shkup.

Burime zyrtare nga drejtoria e Autoritetit portual bëjnë me dije se Panairi “Transport logjistik 2011” është i pari i këtij lloji që hapet në Shkup dhe sipas organizatorëve ka ngjallur interesim, veçanërisht në vendet e rajonit. Në pavijonin ku u instalua stenda e Autoritetit portual ndodheshin edhe stendat e porteve të Tivarit (Mali i Zi) dhe Selanikut (Greqi).

Ndërmarrja më e madhe e transportit detar në vendi tonë është i vetmi subjekt që përfaqësoi Shqipërinë, në panairin ku marrin pjesë 48 firma dhe kompani ndërkombëtare mes të cilave Schenker, MSC, TNT, Bllue Bell, Inter Europa, etj. Ndërkaq mbi 1.200 pjesmarrës të tjerë, kryesisht kontakte biznesi nga vende të ndryshme të botës ishin të pranishëm me kërkesat dhe ofertat e tyre në rrugë elektronike.

Veprimtaria ndërkombëtare është realizuar në periudhën 5-8 tetor. Të pranishmit në Qendrën e Panairëve të Shkupit ndoqën me shumë interes prezantimin e portit të Durrësit dhe perspektivat e tij nga drejtori i përgjithshëm i Autoritetit portual, Eduard Ndreu.

Sipas burimeve çdo ditë janë organizuar 4-5 takime me drejtues të firmave dhe kompanive gjermane, maqedone, kosovare, etj, të interesuara për transportet e mallrave përmes portit detar të Durrësit.

Autoriteti portual gjatë vitit 2011 ka marrë pjesë në katër panairë të organizuara në Tiranë, si dhe në panairin e Prishtinës, në “Fiera del Levante” të Barit (Itali) si dhe në panairin “Transport logjistik 2011” që po vijon këto ditë në Shkup (Maqedoni).

